

DR. MILAN ŠUFFLAY – MIK I MADH I POPULLIT SHQIPTAR



Homazh pranë vendit ku, më 18 shkurt 1931, u godit për vdekje fisniku dhe vizionari politik kroat, dr. Milan Šufflay, mik i madh i popullit shqiptar (1879–1931).

A STUDIOHET NË
SHKOLLAT TONA
SHQIPE VEPRA E
MILAN ŠUFFLAY-T?

Mal Berisha

DR. MILAN ŠUFFLAY – MIK I MADH I POPULLIT SHQIPTAR

Ai nuk ishte shqiptar, por u vra sepse mbrojti historinë e shqiptarëve

Milan Šufflay ishte historian dhe albanolog kroat, i cili iu përkushtua studimit të historisë shqiptare në një kohë kur ajo shtrembërohej ose mohohej.

Ai hulumtoi burimet arkivore për të nxjerrë në dritë lashtësinë dhe vazhdimësinë historike të shqiptarëve, duke e trajtuar historinë si shkencë dhe jo si mjet propagande.

Dr. Milan Šufflay (1879–1931) ishte historian, albanolog, shkrimtar dhe vizionar politik kroat, vepra shkencore e të cilit dha një kontribut të jashtëzakonshëm në historiografinë shqiptare. Ai studioi në Universitetin e Zagrebit dhe u specializua në Vjenë në fushat e historisë mesjetare, paleografisë latine, diplomatikës dhe kërkimeve arkivore.

Interesi i tij për Shqipërinë lindi gjatë studimit të dokumenteve mesjetare të ruajtura në arkivat e qyteteve bregdetare të Dalmacisë. Së bashku me Ludwig von Thallóczy-n dhe Konstantin Jireček-un, botoi veprën monumentale në dy vëllime, *Acta et Diplomata Res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia* (1913–1918). Kjo përmbledhje dokumentesh të pazëvendësueshme për Shqipërinë mesjetare mbetet një nga themelet e albanologjisë moderne.

Šufflay studioi gjithashtu qytetet, kështjellat, dinastitë, fiset, jetën fetare dhe organizimin politik të Shqipërisë mesjetare. Ndër veprat e tij më të rëndësishme përmenden *Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë, kryesisht gjatë Mesjetës, Historia e shqiptarëve të Veriut dhe Gjendja fetare në Shqipëri përgjatë shekujve*. Nëpërmjet kërkimeve të tij të thelluara, ai mbrojti lashtësinë, vazhdimësinë historike dhe identitetin e veçantë të popullit shqiptar.

Ky qëndrim shkencor e bëri atë objekt presioni dhe armiqësie nga qarqe nacionaliste, të cilat nuk i pranonin përfundimet e kërkimeve të tij.

Në janar të vitit 1931, Šufflay vizitoi Shqipërinë për të diskutuar vazhdimin e serisë *Acta Albaniae* dhe hartimin e një historie të plotë të vendit. Pak kohë pas kthimit në Zagreb, më 18 shkurt 1931, ai u godit për vdekje dhe ndërroi jetë të nesërmen.

Nuk u vra për pasuri apo pushtet, por për dijen, veprimtarinë e tij intelektuale dhe mbrojtjen e së vërtetës historike.

Vrasja e tij shkaktoi një reagim të fuqishëm ndërkombëtar. Personalitete të shquara, si Albert Einstein dhe Heinrich Mann, e dënuan publikisht këtë akt.

Për shqiptarët, Šufflay mbetet një nga mbrojtësit më të rëndësishëm të së vërtetës së tyre historike. Ai nuk kërkoi asgjë në këmbim, përveçse që historia të shkruhej drejt.

Pikërisht për këtë arsye, shkova posaçërisht në Zagreb dhe bëra homazhe pranë pllakës përkujtimore kushtuar këtij njeriu të madh, të cilit ia morën jetën sepse e deshi Shqipërinë dhe mbrojti historinë e shqiptarëve.

Në atë pllakë shkruhet:

“Pranë kësaj ndërtese, më 18 shkurt 1931, u godit për vdekje fisniku dhe vizionari politik kroat,

DR. MILAN ŠUFFLAY

(1879–1931),

historian, albanolog dhe shkrimtar.

Këtë pllakë e vendosën në kujtim të tij, në vitin 1994, ‘Vëllezërit e Dragoit Kroat’, me rastin e 900-vjetorit të qytetit të Zagrebit dhe 63-vjetorit të vdekjes së tij.”

Për dijen dhe të vërtetën historike, Milan Šufflay dha jetën.



A STUDIOHET NË
SHKOLLAT TONA
SHQIPE VEPRA E
MILAN ŠUFFLAY-T?

**Homazh pranë vendit
ku, më 18 shkurt 1931,
u godit për vdekje
fisniku dhe vizionari
politik kroat, dr. Milan
Šufflay, mik i madh i
popullit shqiptar
(1879–1931).**



MILAN ŠUFFLAY mbërriti në Shqipëri më 12 janar 1931.

Më 16 janar 1931, ai mbajti një fjalim në Parlamentin Shqiptar, ku paraqiti projektin për vazhdimin e veprës:

“Acta Albaniae dhe hartimin e Historisë së Shqipërisë.

MË 18 SHKURT 1931, E VRANË SHOVINISTËT SERBË.



Milan Šufflay

1879 - 1931

Në vitin 1931, Milan Šufflay, nacionalist kroat dhe anëtar i Partisë së të Drejtave, u vra nga agjentë të Policisë Mbretërore Jugosllave. Vrasja e tij shkaktoi një reagim të fuqishëm ndërkombëtar kundër qeverisë jugosllave. Akti u dënua edhe nga Albert Einstein-i dhe Heinrich Mann-i nëpërmjet një letre drejtuar Lidhjes për të Drejtat e Njeriut.



Në pllakë shkruhet në gjuhën shqipe:

Pranë kësaj ndërtese, më 18 shkurt 1931, u
godit për vdekje

fisniku dhe vizionari politik kroat,

DR. MILAN ŠUFFLAY

(1879–1931),

Ëi ishte historian, albanolog dhe shkrimtar.

Këtë pllakë e vendosën në kujtim të tij, në
vitin 1994, “Vëllezërit e Dragoit Kroat”,

me rastin e 900-vjetorit të themelimit të
qytetit të Zagrebit dhe 63-vjetorit të vdekjes
së tij.



Ne gjuhën kroate:

**PRED OVOM ZGRADOM 18. VELJAČE
1931. G.**

**SMRTNO JE OZLIJEĐEN
HRVATSKI POLITIČKI VIZIONAR
DR. MILAN PL. ŠUFFLAY
(1879.–1931.)**

**POVJESNIČAR, ALBANOLOG I
KNJIŽEVNIK.**

**UZ 900. OBLJETNICU ZAGREBA I 63.
OBLJETNICU SMRTI PODIGOŠE 1994.
BRAĆA HRVATSKOGA ZMAJA.**

ACTA ET DIPLOMATA
RES ALBANIAE MEDIAE AETATIS
ILLUSTRANTIA.

COLLEGERUNT ET DIGESSERUNT

D^r LUDOVICUS DE THALLOČZY, D^r CONSTANTINUS JIREČEK
ET
D^r EMILIANUS DE SUFFLAY.

VOLUMEN I

(ANNOS 344—1343 TABULAMQUE GEOGRAPHICAM CONTINENS).

БИБЛИОТЕКА АРХИВА
ЗА АРБАНАСКУ СТАРИНУ, ЈЕЗИК И ЕТНОЛОГИЈУ.
УРЕДНИК УНИВ. ПРОФ. ДР. Х. БАРИЋ.

Историјска серија.

КНЈ. I.

DR. MILAN ŠUFFLAY
SRBI I ARBANASI

SA PREDGOVOROM
ST. STANOJEVIĆA,
PROF. UNIV. U BEOGRADU.



BEOGRAD
IZDANJE SEMINARA ZA ARBANASKU FILOLOGIJU.
1925.





ALBANOLOGËTË SHQUAR TË HUAJ MILAN ŠUFFLAY

10
LEKË



SHQIPËRIA

Shtyp. Adel CO

2013

N. Bakalli



A STUDIOHET NË
SHKOLLAT TONA
SHQIPE VEPRA E
MILAN ŠUFFLAY-T?

MIQ TË MËDHENJ TË SHQIPËRISË DHE TË SHQIPTARËVE

1. Aubrey Herbert -

Koloneli dhe parlamentar anglez, i cili, në çastet e fundit të jetës, i tha nënës së tij, Konteshës Elizabeth Herbert: "Po ju le amanet Shqipërinë."

2. Kontesha Elizabeth Herbert -

Zonja angleze e konsideruar si "Nëna e shqiptarëve", për shkak të ndihmave të shumta që u dha atyre.

3. Charles Telford Erickson -

Amerikani që themeloi Shkollën Bujqësore Shqiptaro-Amerikane në Golem dhe shkroi veprën "Enigma e Ballkanit". Ai humbi djalin e tij të madh në Elbasan.

4. Milan Šufflay -

Studiuesi kroat që humbi jetën për historinë e Shqipërisë.

5. Edith Durham -

Autorja angleze e veprës "Brenge e Ballkanit" dhe një nga mbrojtëset më të shquara të çështjes shqiptare.

6. Margaret Hasluck -

Antropologja angleze dhe studiuesja e prejardhjes, traditave dhe kulturës së shqiptarëve.

7. George Fred Williams -

Diplomati amerikan, ish-ambasadore në Greqi dhe Mal të Zi, që dha dorëheqjen nga detyra në mbrojtje të shqiptarëve.

8. Ruth Padington -

Vajza angleze që ia kushtoi jetën Kavajës dhe popullit shqiptar.

9. Rose Wilder Lane -

Autorja amerikane që përshkoi Alpet Shqiptare dhe shkroi veprën "Majat e Shalës".

10. Robert Elsie -

Albanologu kanadez që u la shqiptarëve 70 vepra dhe një amanet: "të prehej në Theth".

11. Sir Noel Malcolm -

Historiani britanik, autor i një triptiku historik që përbën një "Shqiptariadë" të jashtëzakonshme në shërbim të çështjes shqiptare.

12. Carleton S. Coon -

Antropologu amerikan që kaloi një vit në Shqipëri dhe kreu matje antropologjike mbi 1 000 shqiptarë; autor i veprës "Malet e Gjigantëve - Gegët e Shqipërisë".

NDERIME PËR JETË!

MIQ TË MËDHENJ TË SHQIPËRISË DHE TË SHQIPTARËVE

1. Aubrey Herbert -

Koloneli dhe parlamentar anglez, i cili, në çastet e fundit të jetës, i tha nënës së tij, Konteshës Elizabeth Herbert: "Po ju le amanet Shqipërinë."

2. Kontesha Elizabeth Herbert -

Zonja angleze e konsideruar si "Nëna e shqiptarëve", për shkak të ndihmave të shumta që u dha atyre.

3. Charles Telford Erickson -

Amerikani që themeloi Shkollën Bujqësore Shqiptaro-Amerikane në Golem dhe shkroi veprën "Enigma e Ballkanit". Ai humbi djalin e tij të madh në Elbasan.

4. Milan Šufflay -

Studiuesi kroat që humbi jetën për historinë e Shqipërisë.

5. Edith Durham -

Autorja angleze e veprës "Brenge e Ballkanit" dhe një nga mbrojtëset më të shquara të çështjes shqiptare.

6. Margaret Hasluck -

Antropologja angleze dhe studiuesja e prejardhjes, traditave dhe kulturës së shqiptarëve.

7. George Fred Williams -

Diplomati amerikan, ish-ambasadore në Greqi dhe Mal të Zi, që dha dorëheqjen nga detyra në mbrojtje të shqiptarëve.

8. Ruth Padington -

Vajza angleze që ia kushtoi jetën Kavajës dhe popullit shqiptar.

9. Rose Wilder Lane -

Autorja amerikane që përshkoi Alpet Shqiptare dhe shkroi veprën "Majat e Shalës".

10. Robert Elsie -

Albanologu kanadez që u la shqiptarëve 70 vepra dhe një amanet: "të prehej në Theth".

11. Sir Noel Malcolm -

Historiani britanik, autor i një triptiku historik që përbën një "Shqiptariadë" të jashtëzakonshme në shërbim të çështjes shqiptare.

12. Carleton S. Coon -

Antropologu amerikan që kaloi një vit në Shqipëri dhe kreu matje antropologjike mbi 1 000 shqiptarë; autor i veprës "Malet e Gjigantëve - Gegët e Shqipërisë".

NDERIME PËR JETË!